

Parathënie

Revista *Kërkime Pedagogjike (Pedagogical Research)* është vazhdimësi e publikimeve vjetore të Institutit Pedagogjik të Kosovës. Këtë vit, si rezultat i projekteve të shumta kërkimore, Kërkime del në dy vëllime. Ky publikim është vëllimi i dytë i revistës *Kërkime Pedagogjike* për vitin 2025. Shtatë artikujt e këtij vëllimi përfshijnë tematika të trajtuara nga punëtorët shkencorë dhe bashkëpunëtorët e Institutit.

Vëllimi i dytë vjetor i revistës *Kërkime Pedagogjike* përqendrohet në analiza të thelluara të politikave arsimore, praktikave gjithëpërfshirëse, zhvillimit profesional dhe kërkimit shkencor në kontekstin arsimor të Kosovës. Artikujt e përfshirë dëshmojnë për një orientim të qartë drejt ndërlidhjes së hulumtimit të aspekteve pedagogjike të punës me proceset vendimmarrëse dhe zhvillimet e vazhdueshme në arsim.

Një aspekt i rëndësishëm tematik lidhet me gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim, pasi trajtohen perceptimet e mësuesve udhëtues për praktikatat gjithëpërfshirëse dhe sfidat që shoqërojnë zbatimin e tyre në nivele të ndryshme institucionale. Këto studime ofrojnë një pasqyrë reale mbi progresin dhe pabarazitë në nivel vendi, duke theksuar nevojën për mekanizma të qëndrueshëm mbështetës, investime të shtuara dhe monitorim të vazhdueshëm.

Një tjetër fokus i këtij vëllimi është zhvillimi i mendimit kritik dhe praktikave reflektuese, veçanërisht në fëmijërinë e hershme dhe në arsimin bazë. Artikujt që trajtojnë mendimin kritik dhe mësimdhënien e gramatikës së gjuhës shqipe në kontekst integruar nxjerrin në pah mospërputhjet ndërmjet perceptimeve teorike dhe praktikave reale në klasë, duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies.

Vëllimi përfshin, gjithashtu, studime që analizojnë udhëheqjen e institucioneve arsimore dhe jetësimin e rekomandimeve të hulumtimeve në politikat dhe praktikatat për arsimin e të rriturve. Këto kontribute theksojnë rëndësinë e standardeve profesionale për drejtorët e shkollave, partneritetit ndërmjet hulumtuesve dhe praktikuesve, si dhe ndërtimit të një kulture të përgjegjësishë dhe llogaridhënies në sistemin arsimor.

Kërkime Pedagogjike

Në plan më të gjerë akademik, trajtimi i kërkimeve ndërdisiplinore në arsimin e lartë e vendos këtë vëllim në dialog me zhvillimet bashkëkohore ndërkombëtare, duke argumentuar nevojën për reforma strukturore, mbështetje institucionale, dhe ndryshim të kulturës akademike për të nxitur inovacionin dhe konkurrencën shkencore.

Në tërësi, vëllimi i dytë i *Kërkimeve Pedagogjike* afirmon rolin e revistës si platformë shkencore për debat të argumentuar, reflektim kritik dhe prodhim të njohurive që kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e politikave dhe praktikave arsimore në Kosovë. U jemi mirënjohës dhe falënderues autorëve të punimeve, redaksisë së revistës dhe recensentëve për kontributin e çmuar profesional në përgatitjen e punimeve në *Kërkime Pedagogjike*.

Dr. Osman Buleshkaj,

Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës